



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

ADMINISTRATA DOGANORE SHQIPTARE

Newsletter | Prill 2025

DOGANAT MARRËVESHJE ME POLICINË PËR LEHTËSIMIN E BIZNESIT, SKANIMI DO TË BËHET VETËM NË BAZË TË ANALIZËS SË RISKUT



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Z. Genti Gazheli, së bashku me Kryeministrin e Shqipërisë, Z. Edi Rama, ministren e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Znj. Delina Ibrahimaj, Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Z. Ilir Proda, Drejtorin e Autoritetit Portual Durrës, Z. Kreshnik Bajraktari, si dhe kryetaren e Bashkisë Durrës, Znj. Emiriana Sako, zhvilluan pranë Degës Doganore Durrës një takim me përfaqësues të kompanive të transportit lidhur me ecurinë e procesit të skanimit në Portin e Durrësit dhe përafrimin e tij me standardet dhe praktikatat më të mira të Bashkimit Europian.

Në përfundim të këtij takimi, nga drejtori i përgjithshëm i Doganave, Z. Genti Gazheli dhe drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Z. Ilir Proda u nënshkrua marrëveshja mes Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për "Një shtesë në Urdhrin e përbashkët të dy drejtorive për miratimin e rregullave "Për bashkëpunimin për kryerjen e procedurave dhe veprimeve të përbashkëta të autoriteteve të Policisë dhe Autoriteteve doganore".

Në bazë të kësaj marrëveshje palët dakordësohen që skanimi të bëhet vetëm në bazë të analizës së riskut, si dhe për krijimin e një njësie të përbashkët kontrolli Polici-Doganë në sheshin e trageteve, ashtu si aktualisht është edhe për sheshin e kontenierëve. Marrëveshja e firmosur zgjidh përfundimisht problematikën e operatorëve ekonomikë, duke reduktuar në maksimum kostot e tyre, si dhe do të rrisë efikasitetin e parandalimit, zbulimit dhe goditjes së trafikëve të paligjshme.

UNODC TRAJNON 13 DOGANIERË DHE OPERATORË POSTARË MBI IDENTIFIKIMIN E ARMËVE DHE ANALIZËN E IMAZHEVE ME RREZE X

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), përmes Programit të saj Global për Armët e Zjarrit, organizoi një kurs të specializuar trajnimi në Tiranë. Kjo nismë, në kuadër të Projektit Hermes, synoi përmirësimin e aftësive të 13 zyrtarëve nga Administrata Doganore dhe Operatorët Postarë të Përcaktuar për të identifikuar sende të paligjshme në pakot postare, me fokus të veçantë tek armët e zjarrit, pjesët, komponentët dhe municionet e tyre.

Trajnimi përfshiu si mësim teorik ashtu edhe ushtrime praktike. Pjesëmarrësit u njohën me funksionimin e skanerëve me rreze X, teknikat e analizimit të imazheve për zbulimin e armëve dhe përbërësve të tyre, si dhe aplikimin e analizës së riskut për identifikimin e kërcënimeve të mundshme në shërbimet postare. Një komponent i rëndësishëm i kursit ishte zhvillimi i sesioneve praktike, përfshirë një vizitë në një vend operativ të inspektimit, ku pjesëmarrësit patën mundësinë të zbatojnë njohuritë e fituara në situata reale.



DOGANA DIGJITALE



Drejtorja e Përgjithshme e Doganave i është bashkuar nismës së Qeverisë për të digjitalizuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset, nëpërmjet platformës **E-Albania**.

Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtime të kohës procedurale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit.

Vetëm gjatë muajit Prill 2025 nga Administrata Doganore Shqiptare janë miratuar **570 shërbime online**.

4 SKANERË TË RINJ NË AEROPORTIN E RINASIT DHE NË PIKAT DOGANORE KAPSHTICË, KAKAVIJË DHE SARANDË

Katër pajisje të reja skaneri për kryerjen e kontrollit të bagazheve të pasagjerëve në mënyrë të shpejtë dhe efikase janë vendosur në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit, si dhe në pikat kufitare të Kapshticës, Kakavijës dhe të Sarandës.

Instalimi i këtyre pajisjeve me rreze X do të rrisë cilësinë e kontrolleve të bagazheve të pasagjerëve, si dhe do të shkurtojë ndjeshëm kohën e kontrollit, duke ruajtur balancën e duhur ndërmjet kontrolleve doganore dhe lehtësimit të tregtisë së ligjshme në çdo pikë doganore.

Skanerët me rreze X do të ndihmojnë në përmbushjen e detyrimeve të sigurisë kombëtare në kufi, si për të garantuar qarkullimin e ligjshëm të udhëtarëve dhe mallrave në këto pika kufitare, në më pak kohë dhe më shumë cilësi, ashtu dhe në kuadër të forcimit të luftës kundër trafikëve të paligjshme.



DREJTORI I DOGANAVE GENTI GAZHELI PRET AMBASADOREN E HUNGARISË, MARTINA KASNYIK

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Z. Genti Gazheli, priti në një takim kortezie Ambasadoren e Hungarisë në Tiranë, Znj. Martina Kasnyik dhe ekspertin e integritetit europian, Znj. Zsuzsanna Beszteri.

Gjatë këtij takimi u diskutua mbi bashkëpunimin e ngushtë, sidomos sa i përket marrëdhënieve ekonomike dhe nxitjen e tregtisë mes dy vendeve tona.

Drejtori i Doganave Z. Genti Gazheli i shprehu Ambasadores, Znj. Martina Kasnyik, mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme që Hungaria i ka dhënë Shqipërisë, në veçanti sa i takon procesit të integritetit të vendit tonë drejt Bashkimit Europian.



BOTOHET LIBRI JESHIL "DOGANAT 2024 DHE PRIORITETET 2025"

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave ka publikuar Librin Jeshil "Doganat 2024 dhe Prioritetet 2025", në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Ky është viti i katërt i botimit të Librit Jeshil në formatin e një raporti vjetor, mbështetur në vizionin e Administratës Doganore për lehtësimin e tregtisë së ligjshme duke ruajtur ekuilibrin e duhur me analizën e riskut dhe kontrollet pas-zhdoganimit.

Digjitalizimi i shërbimeve doganore, lehtësimi i tregtisë së ndershme, shërbimi ndaj biznesit, mbrojtja e interesave financiare të vendit, lufta ndaj kontrabandës dhe evazionit, ishin shtyllat kryesore që shënuan performancën e Doganave Shqiptare për vitin 2024. Thjeshtimi dhe digjitalizimi i procedurave doganore ka dhënë rezultate konkrete në drejtim të uljes së kohës mesatare të shqyrtimit të aplikimeve online nëpërmjet e-Albania.

Gjatë vitit 2024 u shtuan dhe 5 Operatorë Ekonomikë të Autorizuar, duke e çuar në 16 numrin e AEO-ve në total, ndërkohë që janë në shqyrtim dhe shumë kërkesa të tjera për të përfutur këtë status. Veprimtaria e Administratës Doganore do të mbështetet në tre objektiva kryesore për vitin 2025: Efiçensë, Siguri dhe Prosperitet në rrugën e integritetit drejt Unionit Doganor Europian.

